

VATH KORESHI

8SH-32


K 91



HAXHIU I
FRAKULLES

DASMA E SAKOS

novela



854-32
K 91

**VATH
KOBRESHI**

**HAXHIU
I
FRAKULLËS**

**DASMA
E
SAKOS**



**Novela
të
zgjedhura**


Shtëpia Botuese
«NAIM FRASHËRI»

Redaktor

SAMI ÇABEJ

Piktor

SHPEND BENGU



HAXHIU I FRAKULLËS

THE ARDENNES
IN A KENNEDY

PJESA E PARË

Në vjeshtën e vitit... në Berat erdhi udhëta-ri i njohur turk Serdar Ali Hani. Me vete kishte edhe të bijën, Meremxhenë, një nga ato turkeshat e bukura, për të cilën u fol shumë e shumë kohë më pas.

Serdar Aliu erdhi nga Elbasani me karvanin e valiut të vendit Çatallbash pashës. Ai ishte një burrë i gjatë me mjekër e leshra pis të zeza, me një gelebije bojë hashashi dhe me çallmën jeshile, shenjë e fisit të profetit Muhamet. Nderet me të cilat e pritën, qenë të mëdha. Tek

Ura e Goricës i dolën përpara qehajai i spahinjve, komandanti i jeniçerëve, dizdari i fortesës, vojvoda i qytetit, kryetari i bandës muzikore, agai i mjeshtërisë, agai i haraçit. Shpura e tyre me Serdar Ali Hanin në mes dhe me të bijën, që nuk ishte më shumë se 16 vjeçe, shkuan në pallatin e Uzkurliut, ku e pritën sheh Islami, Nekibul-Eshrafi dhe kadiu. Në mbrëmje shtruan një darkë të madhe në pallatin e Osman pashës, të vëllait të Çatallbash pashës.

Serdar Aliun thoshin se sulltani e mbante pranë gjurit. Për shërbimet që i kishte sjellë perandorisë, sulltani i kishte dhuruar atij xhyben e nderit, qëndisur me ar. Për të lajmëruar mbërritjen e këtij njeriu të shquar, në sallon u lexuan urdhra eprorë dhe u nxorrën kasnecë nëpër rrugët e qytetit. Me përgatitjen e darkës u mor vetë Nekibul-Eshrafi. U ndezën të gjithë fenerët e urës dhe të rrugëve në «Murad Çelepi». Uzkurli, Hungar, Vakuf, Baba Kadi, Pashmakxhi, Jazëlli dhe në kullën madhështore të sallahatit, sjellë prej Ardelit. Qyteti sikur që zgjuar papritmas përmes zhurmës dhe llamburitjes marramendëse.

II

Te Tabakhania, ku mblidheshin poetët, oratorët dhe shkrimtarët e vendit, për të cilët më

vonë Serdar Ali Hani shkroi se «... janë me kulturë të lartë dhe me studime të plotë», kishin nisur diskutimet politike. Shkak për këtë që bëri ardhja e këtij personaliteti nga Porta e Lartë. Pastaj, si zakonisht, kishte nisur sherri. Mysli Çakshiri, myderiz nderi, që jepte mësim gratis në melodinë kuranore në xhaminë e Gazi Murad pashës, bëri një kasidë mirëseardhjeje për Serdar Aliun. Ai u ngrit në këmbë dhe recitoi duke iu dridhur buza e duke i ndritur sytë. Mysli Çakshirin, plak zevzek, e plot huqe, e digjte gjithmonë dëshira që të dilte mbi të tjerët. Ai kishte rrëkëllyer një poç verë dhe, i ndezur nga akshi i saj, donte që t'ua përplaste në fytyrë armiqve të tij. Ndërsa recitonte, sytë i mbante nga Nezimi, që ishte ulur në kënd të Tabakhanes, me një xhybe të gjatë e tërë arna, sjellë nga shtegtimi i tij nëpër Persi. Nezimi ia bleu mendjen dhe i priti shigjetat e Çakshirit me një buzagaz tallës. Si u ul plakun, përmes dufit të kasidesë, Nezimi ngriti trupin dhe tha me atë zërin e tij pak të ngjirur, me nota therëse:

*Shiri¹⁾ që bëri Çakshiri,
është si të hash kajmak,
Mos u lodh, o erëzambak,
se nuk bëhetë pahiri.*

1) Poezia

Disa të rinj u përkulën mbi tryezat e tyre dhe kukurisën mbytur. Dacka që e rëndë dhe e fortë. Çakshiri e ndjeu menjëherë dhe, si e shtyu tutje poçin e verës që kishte përpara, u hodh vrik përpjetë. Sytë e tij skuqnin nga tërbimi. Mjekra i dridhej dhe balli i qe mbushur me zhubra. Në fytyrë i lexohej qartë tallazi i mundimit dhe i vuajtjes për të gjetur një përgjigje. Përmes dhëmbëve të rënë i dilte një vërshëllimë e gjatë, a thua se fjalët i kishin mbetur në buzë dhe s'po i shtynte dot përpara. Por më në fund mendja e tij sajoj diçka dhe plaku e holloi dhe e zgjati zërin duke vërvitur në erë gati me histeri këto vargje:

*Si gomari rri pëllet,
zënke edhe bejte flet.*

Çakshiri u ul gjithë triumf dhe e mbështolli xhyben rreth supeve me një shenjë nervoze. Disa zëra qeshën e u zgërdhinë, por Nezimi e priste këtë. Ai buzëqeshte si zakonisht, në mënyrë tallëse dhe përbuzëse. Vërtiste sytë e vegjël e të zgjuar nëpër fytyrat e armiqve të tij. Sollomoni, poeti çifut, qeshte dhe barku i rrumbullakët i kërcente përpjetë. Atij i bëhej zemra mal, se Çakshiri ia kishte thyer samarin keq Nezimit rebel. Po kështu qeshte edhe myftiu i qytetit, Mulla Aliu. Miku i Nezimit rebel, Sulejmani,